

VENDIM
Nr. 512, datë 25.9.2025

**PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË
MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI

1. Miratimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe me programin e Këshillit të Ministrave, ushtron veprimtarinë e saj në këto fusha përgjegjësie shtetërore:

a) harton dhe zbaton politikat për turizmin;

b) harton dhe zbaton politikat e qeverisë në fushën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore, materiale dhe jomateriale, duke përfshirë ruajtjen dhe promovimin e kulturës së shkruar, nxitjen e krijimtarisë artistike dhe industrive krijuese, zhvillimin e edukimit kulturor, mbrojtjen dhe rijetësimin e vlerave kulturore, si dhe rritjen e dialogut e të shkëmbimit kulturor në kuadër të integritetit evropian dhe ndërkombëtar, në përputhje me programin e qeverisë së Republikës së Shqipërisë;

c) harton, programon, zhvillon dhe bashkërendon punën për politikat kombëtare në fushën e sportit, harton politikat mbrojtëse e promovuese, si dhe krijon hapësirat e nevojshme për zhvillimin dhe përmirësimin e sportit shqiptar.

ç) harton dhe zbaton politika që synojnë mbrojtjen e të drejtave të të rinjve dhe garantimin e pjesëmarrjes të të rinjve në jetën sociale.

3. Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit ushtron veprimtarinë në këto fusha përgjegjësie shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës:

3.1 Në fushën e turizmit:

Hartimi dhe zbatimi i politikave për një zhvillim të qëndrueshëm të turizmit, nëpërmjet nxitjes së investimeve në fushën e turizmit, të agroturizmit, ekoturizmit, turizmit ujqor, zonave bregdetare, ngritjes, monitorimit e kontrollimit të sistemit të standardeve në turizëm dhe edukimit të biznesit në fushën e turizmit, të promovimit të produktit dhe destinacioneve turistike, koordinimit e bashkëpunimit me strukturat shtetërore, pushtetin vendor, si dhe ushtrimi i funksioneve të tjera, sipas legjislacionit përkatës, nëpërmjet aparatit të ministrisë dhe institucioneve të saj të varësisë.

3.2 Në fushën e kulturës:

a) harton dhe bashkërendon politikat në fushën e artit dhe kulturës, duke përfshirë rijetësimin e trashëgimisë kulturore, nxitjen e investimeve publike e private në këta sektorë, monitorimin e përdorimit të fondeve publike në mbështetje të zhvillimit kulturor, zhvillimin e edukimit kulturor, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, ruajtjen dhe vijimësinë e traditës së harmonisë fetare, si pjesë përbërëse e kulturës shqiptare, si dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal në fushën e kulturës;

b) harton politika mbrojtëse dhe promovuese për trashëgiminë kulturore, materiale dhe jomateriale, duke krijuar një kuadër të përshtatshëm ligjor e mbështetës për ruajtjen dhe kultivimin e kulturës së shkruar, nxitjen e krijimtarisë artistike në të gjitha fushat, promovimin e arritjeve të kulturës shqiptare dhe rritjen e konkurrueshmërisë së produktit kulturor shqiptar në tregjet ndërkombëtare;

c) harton politika që sigurojnë pjesëmarrjen aktive të Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare në fushën e artit, kulturës dhe trashëgimisë kulturore, përmes aderimit dhe përfaqësimit të saj në institucionet përkatëse;

ç) udhëheq, programon, organizon dhe mbështet veprimtari kombëtare e ndërkombëtare, me synim identifikimin dhe zhvillimin e prirjeve kulturore, artistike e letrare në vend, duke nxitur ndërthurjen e vlerave më të mira kombëtare me ato rajonale e ndërkombëtare, tradicionale e bashkëkohore, si dhe duke krijuar një hapësirë të qëndrueshme dialogu mbarëkombëtar dhe të diversitetit kulturor;

d) realizon regjistrimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to nga subjektet publike ose private, persona fizikë apo juridikë, përdorues të pronësisë letrare, artistike dhe shkencore;

dh) zhvillon politika për mbrojtjen e dijëbërjes dhe mbështetjen e artizanatit, si dhe për formimin e vazhdueshëm të personave të licencuar në pasuritë kulturore materiale.

3.3 Në fushën e sportit:

Harton dhe zbaton politikat shtetërore në fushën e sportit, plotëson dhe përmirëson kuadrin ligjor të sportit, administron fondet buxhetore për sportin dhe kontrollon përdorimin e tyre nga organizatat sportive. Bashkëpunon me organizatat sportive për zhvillimin e sportit në Republikën e Shqipërisë, administron objektet sportive publike, që ka në juridiksion dhe financon ndërtimin e mirëmbajtjen e mjediseve sportive.

3.4 Në fushën e rinisë harton, zhvillon dhe monitoron politikat, për:

a) mbrojtjen e të drejtave të të rinjve në mënyrë gjithëpërfshirëse;

b) krijimin e kushteve të nevojshme për aktivizimin, pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të rinjve;

c) përcaktimin e funksioneve dhe kompetencave të institucioneve në nivel qendror dhe vendor për çështjet e rinisë;

ç) bashkëpunimin me organizatat që ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë;

d) të rinjtë shqiptarë në diasporë, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për diasporën;

dh) programet e shkëmbimit rinor ndërkombëtar.

4. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 2.3.2022, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”, dhe nr. 524, datë 22.9.2021, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët”, shfuqizohen.

5. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama